

ÇFARË NDODH PAS DIPLOMIMIT NGA SHKOLLA

Rezultatet nga
gjurmimi i të
diplomuarve
2016-2022



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SOC

Në partneritet me:

Zbatuar nga:

Ky raport është hartuar nga Jonida Jani nën kujdesin e Aleka Papa, Projekti “Aftësi për Punë” (S4J).
Koordinatorë për gjurmimin në shkollën “Kristo Isak”: Gentjana Hazinedari

Rreth projektit “Aftësi për Punë” S4J

“Aftësi për Punë” S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Lista e figurave

Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2022)	7
Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2022)	7
Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2022)	8
Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2022)	8
Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2016-2022)	9
Figura 6: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2016-2022)	10
Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2022)	10
Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2022)	11
Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2016-2022)	11
Figura 10: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2022)	12
Figura 11: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2022)	12
Figura 12: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2022	14
Figura 13: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net)	15
Figura 14: Niveli i pagave sipas drejtimit (2022)	16
Figura 15: Niveli i pagave sipas gjinisë (2022)	17
Figura 16: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt me kohë të pjesshme (2016-2022)	17
Figura 17: Madhësia e kompanisë (2016-2022)	18
Figura 18: Lloji i kontratës (2016-2022)	19
Figura 19: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2016-2022)	19
Figura 20: Periudha kohore në kërkim të një pune (të diplomuarit 2022)	20
Figura 21: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)	23
Figura 22: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)	24
Figura 23: Lloji i institucionit (2020-2022)	24
Figura 24: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2022)	25
Figura 25: Papunësia ndër vite	25
Figura 26: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2021)	26
Figura 27: Metodatat e kërkimit për punë (2020-2022)	27
Figura 28: Niveli i të diplomuarve papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2016-2022)	28
Figura 29: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2022)	29
Figura 30: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi (2018-2022)	31
Figura 31: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë (2018-2022)	31

Lista e tabelave

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit	6
Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2022)	13
Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2016-2022)	13
Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2016-2022)	14
Tabela 5: Përceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2016-2022)	20
Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2016-2022)	21
Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së pare (2016-2022)	22
Tabela 8: Ndhima e shkollës në gjetjen e punës së pare (2016-2022)	22
Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)	25
Tabela 10: Arsyet kryesore pas papunësisë (2016-2022)	27
Tabela 11: Arsyet kryesore e mos kërkimit për punë (2020-2022)	28
Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë "shumë/jashtëzakonisht shumë" (2016-2022)	29
Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2022)	30
Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2016-2022)	32

Tabela e përmbajtjes


1. Hyrje – Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?	5
2. Të diplomuarit 2016-2022	6
3. Analiza e rezultateve.....	8
3.1 Statusi i punësimit.....	8
3.2 Lidhja e punës me fushën e arsimit	11
3.3 Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës	13
3.4 Niveli i pagave.....	14
3.5 Kushtet e punës	17
3.6 Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqshmërinë me vendin e punës.....	20
3.7 Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë.....	20
3.8 Mënyrat e gjetjes së punës së parë	21
3.9 Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme	23
3.10 Të diplomuarit pa punë.....	25
3.11 Propozimet për përmirësim në shkollë	28
3.12 Planet për të ardhmen	32
4. Përfundime	32

1. Hyrje – Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes ‘studimeve gjurmuese’ që ndjekin ose ‘gjurmojnë’ të diplomuarit pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.


Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, shkolla “**Kristo Isak**”, me mbështetjen e projektit ‘Aftësi për Punë’ (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përmbush dy qëllime të rëndësishme:

- Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
- Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësi të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.

Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësi të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përmblyëse të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarrja e hapave konkrete si rrjedhojë.

Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njesisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit ‘Aftësi për punë’.

Ky raport përmbledhës pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i **shtatë brezave me të diplomuar** të shkollës “Kristo Isak”.


2. Të diplomuarit 2016-2022

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit

Brezi	Të diplomuar	Të anketuar	%
2015-2016	49	40	81%
2016-2017	8	8	100%
2017-2018	72	70	97%
2018-2019	23	22	96%
2019-2020	40	39	98%
2020-2021	38	38	100%
2021-2022	35	35	100%

Nga të diplomuarit e vitit 2021-2022 u gjurmuan 35 nxënës ose 100% e të diplomuarve. Pjesa më e madhe e të diplomuarve të gjurmuar i përkasin gjinisë mashkullore 63% (N=22) dhe vetëm 37% (N=13) gjinisë femërore (shiko figurën 1).


Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2022)



Baza: N=35

Ndërsa të shpërndarë sipas drejtimeve (shiko figurën 2), përqindjen më të lartë të të gjurmuarve e kanë të diplomuarit e drejtimit Hoteleri-Turizëm me 60% (N=21) dhe më të voglin ata të drejtimit Shërbime Sociale dhe Shëndetësore me 17% (N=6).


Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumat e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=35

Të pyetur lidhur me vendbanimin, 74% (N=26) e të diplomuarve janë përgjigjur se jetojnë në Shqipëri dhe 26% (N=9) jetojnë jashtë vendit. Sikurse vërehet nga figura 3, raporti mes numrit të të diplomuarve që jetojnë jashtë vendit dhe atyre që jetojnë në Shqipëri ka mbetur thuajse i pandryshuar për dy vitet e fundit.

Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumat e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=39); 2021 (N=38); 2022 (N=35)


Nga të diplomuarit që jetojnë jashtë vendit, 2 (dy) jetojnë në Greqi dhe 2 (dy) të tjerë në Gjermani. Ndërkohë, në Spanjë, Itali dhe Angli jeton përkatësisht nga 1 (një) i diplomuar në secilin shtet.

3. Analiza e rezultateve

3.1 Statusi i punësimit

Sipas rezultateve të brezit të fundit të të gjurmuarve (2021-2022), nga një total prej 35 të anketuarish 51% ishin të punësuar një vit pas diplomimit (shiko figurë 4), 3% ishin të vetëpunësuar, 3% ishin të punësuar por edhe studionin në të njëjtën kohë dhe 11% ishin student/kursant. Ndërkohë, të papunë ishin 26% e të anketuarve. E shprehur në numër absolut 9 nga 35 të diplomuarit e gjurmuar ishin të papunë.


Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumica e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=35

Referuar figurës 5, mesatarisht 48% e të diplomuarve në të shtatë brezat e gjurmuar janë në marrëdhënie pune një vit pas diplomimit. Ndërkohë, mesatarisht 33% e të diplomuarve janë të papunë dhe 11% vijojnë studimet e mëtejshme.

Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2016-2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumica e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=40); 2017 (N=8); 2018: (N=70); 2019: (N=22); 2020: (N=39); 2021: (N=38); 2022: (N=35)

Të anketuarit që janë shprehur se janë në marrëdhënie pune janë pyetur më tej nëse janë të punësuar apo të vetëpunësuar. Sikurse vihet re nga figura 6, shumica e të diplomuarve ndër vite janë shprehur

se janë të punësuar dhe një numër i vogël prej tyre janë të vetëpunësuar. Kështu, mesatarisht (2016-2022), 40% e të diplomuar punësohen dhe vetëm 7% vetëpunësohen. Niveli më i lartë i vetëpunësimit është shënuar në vitin 2017 me 13% dhe më i ulëti në vitin 2016 dhe 2022 më 3% secili. Ndërkohë, niveli më i lartë i punësimit është shënuar në vitin 2021 më 53%.


Figura 6: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumat e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. % **Baza:** 2016 (N=40); 2017 (N=8); 2018: (N=70); 2019: (N=22); 2020: (N=39); 2021: (N=38); 2022: (N=35)

Në figurën 7, jepet statusi i punësimit sipas tre drejtimeve të ofruara nga shkolla. Sikurse vihet re, 62% (N=13) e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm ishin të punësuar/vetëpunësuar, 19% (N=4) ishin të papunë dhe 14% (N=3) ishin student/kursant një vit pas diplomimit. Ndërkohë, drejtimi Ekonomi-Biznes ka 50% (N=4) të të diplomuarve të papunë dhe vetëm 38% (N=3) të punësuar dhe 1 (një) i diplomuar është student/kursant. E shprehur në përqindje, 13% e të diplomuarve në degën Ekonomi-Biznes vijojnë studime të mëtejshme. Për më tepër, 67% (N=4) e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetsore ishin të punësuar dhe 17% (N=1) ishin papunë një vit pas diplomimit. Asnjë i diplomuar në këtë degë nuk ndjek studime të mëtejshme.


Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** EB (N=8); HT (N=21); SHSSH (N=6)

Të ndara sipas gjinisë (shih figurën 8), të dhënat tregojnë se 86% (N=19) e të diplomuarve meshkuj janë të punësuar dhe 9% (N=2) janë të papunë. Asnjë nga djemtë e diplomuar nuk ka vijuar studime të mëtejshme. Ndërkohë, vetëm 8% (N=1) e të diplomuarave të gjinisë femërore janë të punësuar, 54% (N=7) janë të papuna dhe 31% (N=4) janë studente ose kursante. Sikurse vihet re norma e papunësisë tek vajzat është e lartë.

Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** M (N=22); F (N=13).

3.2 Lidhja e punës me fushën e arsimit

Të pyetur nëse puna aktuale lidhet me fushën e tyre të arsimit, 70% e të diplomuarve në vitin 2022 u përgjigjën pozitivisht. Ndër vite (shiko figurën 9), më shumë se 71% e të diplomuarve pohojnë se puna lidhet me fushën e tyre të studimit.


Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=9); 2017 (N=5); 2018 (N=31); 2019 (N=6); 2020 (N=23); 2021 (N=24); 2022 (N=20)

Nëse analizojmë lidhjen e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit për vitin 2022 (shiko figurën 10), vërehet se vetëm gjysma e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore dhe 69% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm pohojnë se puna që bëjnë lidhet me fushën e tyre të arsimit. Ndërkohë, 100% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes bëjnë një punë që lidhet me fushën e tyre të arsimit.


Figura 10: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumat e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2022:** N_{SHSSH}=4, N_{HT}=13, N_{EB}=3

Të ndara sipas gjinisë, të dhënat tregojnë se 68% (N=13) e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 100% (N=1) e gjinisë femërore punojnë në profesion.

Figura 11: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumat e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** M (N=19); F (N=1).

Të pyetur lidhur me arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (shiko tabelën 2), vërehet se të diplomuarit ndër vite japin si arsye kryesore pamundësinë e gjetjes së një vendi pune që lidhet me studimet e tyre. Kështu, mesatarisht 79% e të diplomuarve në vitet 2018-2021 që kanë pohuar se puna që bëjnë nuk lidhet me arsimin e tyre, kanë dhënë si arsye kryesore pamundësinë e gjetjes së një pune që lidhet me studimet. Ndërkohë, gjatë vitit 2022 kemi një rënie me 29 pikë përqindje për këtë kategori (50%). Një arsye tjetër është mungesa e dëshirës për të punuar në një punë që lidhet me studimet, 33% për vitin 2022, 13% në 2021, 0% në vitet 2018-2020. Arsyeja e tretë që kanë dhënë të gjurmuarit e vitit 2022 është mungesa e ofertave të punës në fushën e tyre të studimit në rajon (17%). Ndërkohë, në vitet e mëparshme kjo nuk ka qenë një arsye për mospërputhjen e punës me fushën e arsimit (mesatarja 2018-2021, 0%)

Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2022)

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Nuk gjeta një vend pune që lidhet me studimet e mia	90%	100%	50%	75%	50%
Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me studimet e mia	0%	0%	0%	13%	33%
Nuk ka oferta pune në fushën time në rajon	0%	0%	0%	0%	17%
Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	10%	0%	50%	0%	0%
Tjetër	0%	0%	0%	13%	0%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=10); 2019 (N=1); 2020 (N=4); 2021 (N=8); 2022 (N=6)

3.3 Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës

Të pyetur nëse njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimit i përdorin në vendin e punës (shiko tabelën 3), rezultatet e gjurmimit të të diplomuarve në vitin 2022 tregojnë se njohuritë përdoren “shumë/jashtëzakonisht shumë” nga 75% e të gjurmuarve. Vihet re një ulje me 8 pikë përqindje në krahasim me vitin e mëparshëm (83%). Niveli më i lartë ka qenë ai i vitit 2017 ku 100% e të diplomuarve kanë pohuar se i përdorin njohuritë dhe kompetencat e fituara në shkollë në vendin e punës në shkallën “shumë/jashtëzakonisht shumë”.

Ndërkohë, vetëm 5% e të diplomuarve në vitin 2022 janë përgjigjur se i përdorin “aspak” njohuritë e fituara gjatë studimeve. Mesatarja e viteve 2016-2021 ka qenë 10%. Ndërsa kategoria e atyre që janë përgjigjur se i përdorin “disi” njohuritë për vitin 2022 është 20%, dhe kemi një ulje me 2 pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2016-2021 e cila ka qenë 22%.

Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2016-2022)

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
Të diplomuar në 2016	22%	33%	11%	22%	11%
Të diplomuar në 2017	0%	0%	0%	40%	60%
Të diplomuar në 2018	6%	6%	68%	19%	0%
Të diplomuar në 2019	10%	10%	20%	20%	40%
Të diplomuar në 2020	17%	26%	26%	13%	17%
Të diplomuar në 2021	4%	4%	8%	50%	33%

Të diplomuar në 2022	5%	0%	20%	35%	40%
----------------------	----	----	-----	-----	-----

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=9); 2017 (N=5); 2018 (N=31); 2019 (N=32); 2020 (N=10); 2021 (N=23); 2022 (N=24)

Të pyetur për lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve të kryera (shiko tabelën 4), 65% e të diplomuarve në 2022 e vlerësojnë lidhjen e pozicionit të punës me studimet e kryera me “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Këtu, vihet re një ulje me 14 pikë përqindje krahasuar me vitin 2021, ku 79% e të diplomuarve të gjurmuar e vlerësonin lidhjen mes pozicionit të punës me “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Nga ana tjetër, 15% e vlerësojnë me “pak/aspak” lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimit. Në vitin 2021, 13% e të diplomuarve e vlerësonin me “pak/aspak” lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve, pra kemi një përmirësim me 2 pikë përqindje në këtë aspekt.

Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2016-2022)


	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
Të diplomuar në 2016	22%	22%	22%	11%	22%
Të diplomuar në 2017	0%	0%	40%	20%	40%
Të diplomuar në 2018	19%	3%	52%	13%	13%
Të diplomuar në 2019	20%	10%	40%	30%	0%
Të diplomuar në 2020	22%	22%	22%	4%	30%
Të diplomuar në 2021	13%	0%	8%	46%	33%
Të diplomuar në 2022	0%	15%	20%	25%	40%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=9); 2017 (N=5); 2018 (N=31); 2019 (N=10); 2020 (N=23); 2021 (N=24); 2022 (N=20)

3.4 Niveli i pagave

Përsa i përket nivelit të pagave për të diplomuarit e punësuar, një vit pas diplomimit, për vitin 2022 (shiko figurën 12), shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 5% më pak se paga minimale, 20% paga minimale-35,000 lekë, 10% në fashën 35,001-50,000 lekë, 15% në fashën 50,001-65,000 lekë, 20% në fashën 65,001-80,000 lekë dhe 30% paguhen më shumë se 80,001 lekë. E shprehur në vlerë absolute 6 nga 20 të diplomuarit e punësuar marrin një pagë më shumë se 80,001 lekë një vit pas diplomimit.


Figura 12: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2022



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=20

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko figurën 13), pasqyron një përmirësim të nivelit të pagave të të diplomuarve në tre vitet e fundit. Kështu, përqindja e atyre që marrin një pagë më shumë se 80,001 lekë është rritur me 27 pikë përqindje në raport me vitin 2020 (30% në 2022, 13% në 2020). Nga ana tjetër, është ulur me 30 pikë përqindje numri i të gjurmuarve që paguhen më pak se paga minimale (35% në 2020, 5% në 2022). Ndërkohë, një tjetër kategori page e cila ka pësuar rritje është 65,001 – 80,000 lekë ku në vitin 2020 vetëm 4% e të diplomuarve deklarorin se e merrnin këtë pagë një vit pas diplomimit, ndërsa në vitin 2022, 20% e të diplomuarve e marrin këtë pagë. Pra, të diplomuarit që paguhen me këtë kategori page kanë pësuar një rritje me 16 pikë përqindje.

Figura 13: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=9); 2017 (N=5); 2018 (N=31); 2019 (N=6); 2020 (N=23); 2021 (N=24); 2022 (N=20)

Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve (shiko figurën 14), vëmë re se 67% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 31% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm paguhen më shumë se 80,001 lekë.

E shprehur kjo në numër absolut 2 (dy) të diplomuar në Ekonomi-Biznes dhe 4 (katër) të diplomuar në Hoteleri-Turizëm marrin një pagë më të lartë se 80,001 lekë.

Për më tepër, 33% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 23% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm paguhen me një pagë 65,001 – 80,000 lekë. Ndërkohë, të diplomuarit në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore (100%) paguhen me pagë minimale-35,000 lekë.

Figura 14: Niveli i pagave sipas drejtimit (2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** $N_{EB}=3$, $N_{HT}=13$, $N_{SHSSH}=4$

Nga të dhënat e disagreguara sipas gjinisë (figura 15), 32% e djemve të diplomuar marrin një pagë më shumë se 80,001 lekë. E shprehur në numër absolut 6 nga 19 djemtë e gjurmuar marrin një pagë më shumë se 80,001 lekë një vit pas diplomimit. Ndërkohë, 21% të tjerë marrin një pagë 65,001-80,000 lekë. Në numër absolut, 4 nga 19 të diplomuarit marrin pagën e mësipërme. Për më tepër, 16% marrin 50,001 – 65,000 lekë dhe 16% të tjerë pagë minimale - 35,000 lekë.

Sikurse vihet re nga figura 15, 100% e vajzave të gjurmuara marrin një pagë minimale – 35,000 lekë një vit pas diplomimit. E shprehur në numër absolut 1 (një) vajzë merr pagën e mësipërme.

Figura 15: Niveli i pagave sipas gjinisë (2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** M (N=19); F (N=1).

3.5 Kushtet e punës

Të pyetur lidhur me karakteristikat kryesore të punës (me kohë të plotë apo të pjesshme), për të shtatë brezat e gjurmuar vërehet që mbizotëron punësim me kohë të plotë (mesatarja e të shtatë brezave 90%). Mesatarisht (2016-2021), 5% e të diplomuarve kanë punuar në punë me kohë të plotë sezonale. Ndërkohë, në vitin 2022, 11% e të diplomuarve punojnë punojnë në punë me kohë të plotë sezonale, duke shënuar një rritje me 6 pikë përqindje nga mesatarja (2016-2021). Vërehet se punësimi me kohë të pjesshme është relativisht i vogël. Kështu, të shprehura në numër absolut, 5 (pesë) të diplomuar në vitin 2018, 2 (dy) të diplomuar në vitin 2020 dhe 1 (një) i diplomuar në vitin 2021, kanë punuar me kohë të pjesshme.

Figura 16: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt me kohë të pjesshme (2016-2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=8); 2017 (N=4); 2018 (N=28) 2019 (N=4); 2020 (N=20), 2021 (N=21); 2022 (N=19)

Përsa i përket shpërndarjes së të diplomuarve sipas tipologjisë së kompanisë (shiko figurën 17), në brezin e fundit të të gjurmuarve vërehet se 58% e të diplomuarve punojnë në kompani me 1-4 punonjës, 21% në kompani me 5-9 punonjës, dhe 16% në kompani me 10-49 punonjës. Numri i të diplomuarve që punojnë në kompani me mbi 50 punonjës vazhdon të mbetet i ulët 5%. Kjo kategori ka pësuar një ulje me 6 pikë përqindje (11% mesatarja 2016-2021).

Ndërkohë, në një vështrim krahasues me vitet e mëprashme, 45% e të diplomuarve kanë punuar në kompani me 1-4 (58% në 2022), 29% në kompani me 5-9 punonjës (21% në 2022) dhe 15% në kompani me 10-49 punonjës (16% në 2022).

Figura 17: Madhësia e kompanisë (2016-2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=6); 2017 (N=4); 2018 (N=28) 2019 (N=4); 2020 (N=20), 2021 (N=21); 2022 (N=19)

Në vitin 2022, 63% e të diplomuarve kanë një kontratë pune me punëdhënësin e tyre (shiko figurën 18). Nga ku 21% kanë një kontratë pune me afat të caktuar dhe 42% me afat të pacaktuar. Ndërkohë, i lartë është numri i atyre që nuk kanë një kontratë (37%). E shprehur në numër absolut 7 të diplomuar nuk kanë një kontratë pune me punëdhënësin e tyre. Në këtë kategori nuk kemi ndryshime krahasuar me mesataren e viteve 2016-2021 (37%).

Sikurse vihet re edhe nga figura 18, lloji i kontratës që mbizotëron është ajo me afat të caktuar. Mesatarja e të shtatë brezave të gjurmuar është 30%. Ndërkohë, mesatarja e atyre me kontratë me afat të pacaktuar është 26%.

Figura 18: Lloji i kontratës (2016-2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=8); 2017 (N=4); 2018 (N=28) 2019 (N=4); 2020 (N=20), 2021 (N=21); 2022 (N=19)

Sipas rezultateve të gjurmimit të të shtatë brezave, mesatarisht 78% e të diplomuave të punësuar deklarojnë se iu paguhen kontributet e detyrueshme nga ana e punëdhënësit (shiko figurën 19). Në vitin 2022 kemi një ulje me 27 pikë përqindje referuar vitit 2021 (90%) dhe me 17 pikë përqindje referuar viti 2020 (80%).

Ndërkohë, gjatë vitit 2022 është rritur edhe numri i atyre të cilëve nuk u paguhen kontributet. Ky vit ka shënuar vlerën 21%, ndërkohë që mesatarja 2016-2021 ka qenë 8%. Për më tepër, është rritur edhe numri i të diplomuarve të cilët nuk kanë informacion nëse u paguhen apo jo kontributet në 16% (2022) nga 12% që ka qenë në vitin 2021.

Figura 19: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=8); 2017 (N=4); 2018 (N=28) 2019 (N=4); 2020 (N=20), 2021 (N=21); 2022 (N=19)

3.6 Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqshmërinë me vendin e punës

Të pyetur se sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjeheshin në vendin e tyre të punës, 68% e të diplomuarve në vitin 2022, u shprehën se ndjehen “të sigurt ose shumë të sigurt” (shiko tabelën 5). Këtu vihet re një përmirësim me 29 pikë përqindje në raport me vitin 2021, ku 39% e të diplomuar janë shprehur se ndjeheshin “të sigurt ose shumë të sigurt” në punën e tyre.

Për vitin 2022 asnjë i diplomuar i gjurmuar nuk është shprehur se ndjehet “shumë i pasigurt” në punën aktuale. Ndërkohë, mesatarisht 11% e të diplomuarve në vitet 2016-2022, janë shprehur “shumë të pasigurt”. Si rezultat, kemi një përmirësim me 11 pikë përqindje në këtë kategori.

Ndërkohë, të pyetur lidhur me kënaqësinë në vendin e punës, 64% e të diplomuarve në vitin 2022 shprehen se ndjehen “të kënaqur ose shumë të kënaqur” dhe vetëm 5% shprehen “shumë të pakënaqur”. Sikurse e tregon edhe tabela 4, numri i atyre që shprehen shumë të pakënaqur ka përsur një rritje në raport me dy vitet e mëparshme (2020-2021), ku asnjë i diplomuar nuk është shprehur se ndjehej “shumë i/e pakënaqur”. E shprehur në numër absolut, 1 (një) i/e diplomuar është shprehur “shumë i/e pakënaqur”.

Tabela 5: Përceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2016-2022)


	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
<i>Shumë i/e pasigurt</i>	13%	0%	14%	25%	5%	10%	0%
<i>I/e pasigurt</i>	0%	25%	36%	0%	5%	19%	0%
<i>Neutral</i>	0%	25%	7%	50%	45%	33%	32%
<i>I/e sigurt</i>	75%	25%	43%	25%	30%	29%	47%
<i>Shumë i/e sigurt</i>	13%	25%	0%	0%	15%	10%	21%
<i>Shumë i/e pakënaqur</i>	0%	0%	7%	25%	0%	0%	5%
<i>I/e pakënaqur</i>	0%	0%	11%	0%	10%	14%	0%
<i>Neutral</i>	0%	50%	11%	50%	40%	5%	32%
<i>I/e kënaqur</i>	88%	0%	71%	0%	35%	76%	53%
<i>Shumë i/e kënaqur</i>	13%	50%	0%	25%	15%	5%	11%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=8); 2017 (N=4); 2018 (N=28) 2019 (N=4); 2020 (N=20), 2021 (N=21); 2022 (N=19)

3.7 Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për kohën që u duhet të presin derisa të fillojnë punën e tyre të parë, 79% e të diplomuarve në vitin 2022 u përgjigjën se kanë arritur të gjejnë punën para diplomimit (shiko figurën 20). Në vitin 2021 (shiko tabelën 6) vetëm 52% e të diplomuaritve u përgjigjën se kishin arritur të gjenin punë para përfundimit të shkollës. 2022-shi shënon vitin me numrin më të lartë të atyre që e fillojnë punën para se të diplomohen. Rritja është 48 pikë përqindje referuar mesatares vjetore të viteve 2016-2021 (31%).

Figura 20: Periudha kohore në kërkim të një pune (të diplomuarit 2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=24

Ndërkohë, 4% e të diplomuarve arrijnë të gjejnë punë 1 muaj pas diplomimit, mesatarja e viteve 2016-2021 është 10%. Pra, për këtë kategori vërehen përmirësime me 6 pikë përqindje. Përmirësime vërehen edhe në numrin e atyre të diplomuarve që gjejnë punë 1-3 muaj pas diplomimit (0% në 2022, përkundrejt 15% (mesatarja) në vitet 2016-2021), si dhe atyre që e gjejnë punën 3-6 muaj pas diplomimit (8% në 2022, përkundrejt 16% (mesatarja) në vitet 2016-2021). Vlen të theksohet se përqindja e atyre që gjejnë punë 1 vit pas diplomimit vijon të mbetet 0 (zero) për të gjithin vit radhazi.

Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Para diplomimit	17%	25%	17%	25%	50%	52%	79%
1 muaj pas diplomimit	33%	0%	3%	13%	0%	12%	4%
1 - 3 muaj pas diplomimit	0%	25%	14%	25%	18%	8%	0%
3 - 6 muaj pas diplomimit	8%	25%	31%	0%	14%	20%	8%
6 - 9 muaj pas diplomimit	17%	0%	34%	13%	14%	4%	8%
9 - 12 muaj pas diplomimit	0%	25%	0%	25%	5%	4%	0%
Më shumë se 1 vit pas diplomimit	25%	0%	0%	0%	0%	0%	0%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=5); 2017 (N=11); 2018 (N=30); 2019 (N=26); 2020 (N=36); 2021 (N=51); 2022 (N=43)

3.8 Mënyrat e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për mënyrën e gjetjes së punës së parë, vlen të theksohet se të diplomuarit e vitit 2022 shprehen në masën 38% se e kanë gjetur punën nga praktika profesionale në biznes. Kjo është përqindja më e lartë e raportuar nga të shtatë brezat e gjurmuar.

Ndërkohë, mënyra që mbizotëron në të shtatë brezat e gjurmuar për gjetjen e një pune janë lidhjet personale të pjesëtarëve të familjes dhe të njohurit e tyre me një mesatare prej 54% (2016-2022). Pas saj renditet praktika profesionale me një mesatare prej 19% (2016-2022).

Gjithashtu, në tre vitet e fundit vihet re edhe një rritje e atyre që shprehen se gjejnë punë nëpërmjet zyrës së punës (21% në 2022, 12% në 2021 dhe 5% në 2020).

Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së pare (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë	25%	0%	17%	0%	0%	12%	4%
Nga njohjet, lidhjet familjare, miqtë	67%	75%	41%	63%	68%	40%	25%
Nga praktika profesionale në biznes	0%	25%	10%	25%	14%	24%	38%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim	8%	0%	7%	13%	14%	8%	4%
Nga mësuesit	0%	0%	3%	0%	0%	0%	8%
Nga Zyra e Punësimit	0%	0%	7%	0%	5%	12%	21%
Nga qendra e karrierës/njësia e zhvillimit në shkollë	0%	0%	14%	0%	0%	4%	0%
Tjetër	25%	0%	17%	0%	0%	12%	4%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=12); 2017 (N=4); 2018 (N=29); 2019 (N=8); 2020 (N=22); 2021 (N=25); 2022 (N=24)

Lidhur me mënyrat e mbështetjes së shkollës në kapërcimin e fazës tranzitore drejt tregut të punës (shiko tabelën 8), në vitin 2022, 35% u shprehën se shkolla u ka mësuar se si të kërkojnë dhe aplikojnë për punë. Këtu vihet re një rritje me 11 pikë përqindje nga mesatarja e vitetve 2016-2021 (24%).

Ndërkohë, 30% janë shprehur se shkolla i ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme për punësim, me një ulje me 17 pikë përqindje referuar mesatares së viteve 2016-2021 (47%). Për më tepër, 30% të tjerë janë shprehur se shkolla i ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë me një rritje me 18 pikë përqindje referuar mesatares 2016-2021 (22%).

Ndërkohë 1 (një) i diplomuar i gjurmuar ose 5% është shprehur se shkolla nuk e ka ndihmuar për gjetjen e një pune. Këtu vërehet një përmirësim me 5 pikë përqindje referuar mesatares së viteve 2016-2021 (10%).

Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së pare (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	0%	20%	29%	30%	39%	25%	35%
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	44%	60%	55%	30%	52%	42%	30%
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë	22%	20%	26%	20%	13%	29%	30%
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	22%	0%	3%	20%	9%	4%	5%
Tjetër	11%	0%	3%	0%	0%	8%	15%


Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=9); 2017 (N=5); 2018 (N=31); 2019 (N=10); 2020 (N=23); 2021 (N=24); 2022 (N=20)

3.9 Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme

Referuar figurës 21, numri i të diplomuarve që punojnë dhe studiojnë në të njëjtën kohë mbetet shumë i vogël. Në total për të shtatë vitet e gjurmara, numri i të diplomuarve që punojnë dhe studiojnë në të njëjtën kohë është 4 (katër). Përkatësisht, 2(dy) të diplomuar në 2020, dhe nga 1 (një) i diplomuar në 2021 dhe 2022, punojnë dhe studiojnë në të njëjtën kohë.

Ndërkohë, numri i të diplomuarve që janë student/kursant për vitin 2022 është 4 (katër). Mesatarisht nga viti 2016-2021, 6 (gjashtë) të diplomuar janë student/kursant në vit. E shprehur në përqindje mesatarisht nga viti 2016-2021, 14% e të diplomuarve janë student/kursant në vit. Ndërkohë, në vitin 2022, kjo përqindje ka rënë me 3 pikë (11%).


Figura 21: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=40); 2017 (N=8); 2018 (N=70); 2019 (N=22); 2020 (N=39); 2021 (N=38); 2022 (N=35)

Sikurse në vitet paraardhëse, 80% e të diplomuarve në 2022 që ndjekin kualifikime të mëtejshme kanë zgjedhur universitetin (4 nga 5 të gjurmuar). Ndërkohë, 20% (1 nga 5 të gjurmuar) ndjekin një kurs profesional. Vihet re se numri më i ulët i të diplomuarve që vijojnë studimet universitare ka qenë në vitin 2020, me 20%. Në këtë vit është shënuar njëkohësisht edhe numri më i lartë i të diplomuarve që ndjekin një kurs profesional (60%).

Figura 22: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=10); 2018 (N=15); 2019 (N=4); 2020 (N=5); 2021 (N=5); 2022 (N=5)

Shënim: Mungojnë të dhënat për vitin 2017

Nga të diplomuarit që ndjekin studime të mëtejshme, për vitin 2022, 60% ndjekin një institucion publik dhe 40% një institucion privat. Vihet re një përbysje e llojit të institucioneve të përzgjedhura në raport me vitin 2020 ku vetëm 20% zgjidhnin një institucion publik dhe 80% një institucion privat.


Figura 23: Lloji i institucionit (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=5); 2021 (N=5); 2022 (N=5)

Ndërkohë, të pyetur nëse studimet/trajnimet që po ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë (shiko figurën 24), 60% (3 nga 5) e të gjurmuarve që studiojnë janë shprehur se fusha e studimeve që po ndjekin tani lidhet me shkollën që kanë bërë, përkundëjt 40% (2 nga 5) të cilët shprehen se studimet e mëtejshme nuk lidhen me shkollën që kanë bërë. Ky vit shënon një përmirësim të dukshëm në raport me dy vitet e mëparshme. Në vitin 2021 vetëm 20% (1 nga 5) dhe në vitin 2020 vetëm 40% (2 nga 5) të diplomuar shpreheshin që studimet/trajnimet që ndiqnin lidheshin me shkollën që kishin bërë.

Figura 24: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=5); 2021 (N=5); 2022 (N=5)

Të pyetur mbi arsyet e ndjekjes së studimeve të mëtejshme (shiko tabelën 9), 60% e të diplomuarve në 2022 janë përgjigjur për të fituar një kualifikim më të lartë (40% në 2021) dhe 40% për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale (60% në 2021). Ndërkohë, për të tretin vit radhazi asnjë i diplomuar nuk jep si arsye mundësinë për të gjetur një punë më të mirë.

Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Për të fituar një kualifikim më të lartë	60%	40%	0%	20%	40%	60%
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	20%	27%	25%	0%	0%	0%
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	10%	27%	75%	80%	60%	40%


Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=10), 2018 (N=15); 2019 (N=4); 2020 (N=5); 2021 (N=5); 2022 (N=5)

Shënim: Mungojnë të dhënat për vitin 2017

3.10 Të diplomuarit pa punë

Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit për vitin 2022 është 26% për vitin 2022. Norma e papunësisë ka rënë me 24 pikë përqindje referuar viti 2019, vit në të cilin është shënuar vlera më e lartë e papunësisë me 50%.


Figura 25: Papunësia ndër vite



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=40); 2017 (N=8); 2018 (N=70); 2019 (N=22); 2020 (N=39); 2021 (N=38); 2022 (N=35)

Të pyetur nëse po kërkonin punë, 4 nga 9 të diplomuarit e papunë të vitit 2022 u përgjigjën po. Edhe një vit më parë 4 nga 9 të diplomuarit e papunë u shprehën se ishin në kërkim të një pune. Ndërkohë, në vitin 2020, 8 nga 11 të diplomuarit e papunë po kërkonin një punë. Dy vitet e fundit, 56% e të diplomuarve të papunë ose 5 nga 9 në secilin vit, nuk po kërkonin për një punë.

Figura 26: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2021)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=11); 2021 (N=9); 2022 (N=9)

75% e të diplomuarve të papunë për vitin 2022 janë shprehur se arsyeja kryesore e papunësisë (shiko tabelën 10), është se oferta për punë nuk lidhet me arsimin e tyre. Në raport me vitet e kaluar kemi një rritje me 60 pikë përqindje në këtë kategori (mesatarja 2016-2021, 15%). Ndërkohë, 25% e të

diplomuarve në 2022 u shprehen që u mungon eksperiencia e punës. Mesatarja e viteve 2016-2021 për këtë kategori është 9%.

Tabela 10: Arsyet kryesore pas papunësisë (2016-2022)


	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Më mungon eksperiencia e punës	21%	0%	9%	0%	25%	0%	25%
Njohuritë që kam marrë nga shkolla nuk përputhen me tregun e punës	14%	0%	9%	0%	0%	0%	0%
Ofertat për punë nuk lidhen me arsimimin tim	21%	0%	32%	9%	0%	25%	75%
Nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë	7%	67%	0%	9%	13%	25%	0%
Nuk ka punë në qarkun tim	14%	0%	23%	9%	38%	25%	0%
Jam i/e angazhuar në punë familjare	14%	33%	14%	18%	0%	0%	0%
Nga situata e krijuar nga pandemia e COVID-	0%	0%	14%	0%	0%	0%	0%
Nuk kam burime të mjaftueshme për t'u vetë-punësuar	0%	0%	0%	45%	0%	0%	0%
Tjetër	7%	0%	0%	9%	25%	25%	0%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=14); 2017 (N=3); 2018 (N=22); 2019 (N=11); 2020 (N=8); 2021 (N=4); 2022 (N=4)

Të pyetur rreth formave që përdorin për të kërkuar një vend pune (shiko figurën 27), 50% (2 nga 4) e të diplomuarve në 2022 janë përgjigjur nëpërmejt njohjeve, lidhjeve familjare, miqve dhe të njohurve, 25% (1 nga 4) nëpërmjet njoftimeve për punë në faqe interneti, media sociale, gazeta etj, dhe po aq duke kontaktuar drejtpërdrejtë me biznesin. Vëreni, të gjurmuarit mund të zgjedhin më shumë se një alternativë për këtë pyetje.

Sikurse vihet re, gjetja e një vendi pune përmes njohjeve, lidhjeve familjare, miqve dhe të njohurve mbetet ndër vite metoda kryesore e kërkimit të një pune.

Figura 27: Metodatat e kërkimit për punë (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=8); 2021 (N=4); 2022 (N=4)

Të pyetur për arsyet e mos kërimit të një pune (shiko tabelën 11), 3 nga 5 të gjurmuarit e papunë të cilët nuk po e kërkonin një punë u shprehën se nuk kishin dëshirë të punonin për momentin, ndërsa 1 nga 5 priste të fillonte punë së shpejti. Gjithashtu, 1 nga 5 të diplomuarit e papunë që nuk po e kërkonte një punë u shpreh se kishte në plan të largohej nga vendi.


Tabela 11: Arsyet kryesore e mos kërimit për punë (2020-2022)

c	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Po pres të filloj punë së shpejti	0	0	1
Nuk kam besim se do gjej një punë	0	1	0
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	2	4	3
Kam në plan të largohem nga vendi	1	0	1

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=3); 2021 (N=5); 2022 (N=5)

Sikurse e tregon edhe figura 28, numri i të diplomuarve të papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune më parë në vitin 2022 ka shënuar nivelin më të lartë me 56%. Ndërkohë, niveli më i ulët është shënuar në vitin 2017 me 0%.

Figura 28: Niveli i të diplomuarve papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2016-2022)



Shënim, figura 24: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=14); 2017 (N=3); 2018 (N=22); 2019 (N=11); 2020 (N=11); 2021 (N=9); 2022 (N=9)

3.11 Propozimet për përmirësim në shkollë

Të pyetur se për çfarë aspektesh ka nevojë për përmirësim shkolla me qëllim përgatitjen më të mirë të nxënësve për tregun e punës, të gjurmuarit pohuan se të gjitha aspektet e shkollës të paraqitura në tabelën 12 kanë “shumë/jashtëzakonisht shumë” nevojë për përmirësim. Sipas rezultateve të të

gjurmuarve në vitin 2022, theksi është vënë tek nevoja për përmirësim të bashkëpunimit me bizneset, 74% (me një ulje me 12 pikë përqindje krahasuar me vitin 2021).

Për më tepër, 71% kërkojnë përmirësimin e praktikës në shkollë dhe pa aq (71%) të praktikës në biznes, 69% përmirësimin e aftësive teorike dhe praktike të mësuesve, 69% këshillimin e karrierës dhe po aq (69%) bashkëpunimin me zyrat e punës.


Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkollë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
<i>Infrastruktura</i>	44%	20%	19%	20%	31%	90%	60%
<i>Kurrikula</i>			19%	20%	28%	67%	57%
<i>Tekstet dhe materialet</i>	22%	20%	16%	40%	28%	70%	22%
<i>Metodat e mësimdhënies</i>	56%	20%	16%	60%	26%	81%	60%
<i>Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve</i>			32%	30%	33%	83%	69%
<i>Praktika në shkollë</i>	33%	60%	35%	40%	49%	81%	71%
<i>Praktika në biznes</i>	11%	100%	39%	60%	51%	91%	71%
<i>Këshillimi i karrierës</i>	11%	60%	45%	30%	41%	76%	69%
<i>Bashkëpunimi me bizneset</i>	22%		42%	50%	49%	86%	74%
<i>Bashkëpunimi me zyrat e punësimit</i>	33%	20%	16%	60%	49%	78%	69%

Shënim: Kjo është pyetje ku janë marrë të dhënat e të diplomuarve që janë përgjigjur “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=9); 2017 (N=5); 2018 (N=31); 2019 (N=10); 2020 (N=39); 2021 (N=36); 2022 (N=35)

Nëse do të kishin mundësi, 83% e të diplomuarve do të zgjidhnin të njëjtin drejtim profesional dhe 80% të njëjtën shkollë (shiko figurën 29). Mesatarisht, nga viti 2018-2022, 91% e të diplomuarve do të përzgjidhnin të njëjtën degë, dhe po aq (91%) të njëjtën shkollë.

Figura 29 Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=69); 2019 (N=22); 2020 (N=39); 2021 (N=38); 2022 (N=35)

Të disagreguara sipas drejtimeve, përzgjedhja e të njëjtës degë dhe shkollë paraqitet në tabelën 13. Vëmë re se të diplomuarit e degës Ekonomi-Biznes në vitin 2022, do e përzgjidhnin të njëjtën degë në masën 88% dhe të njëjtën shkollë në masën 75%. Mesatarja e viteve 2018-2020 ka qenë 86% do të zgjidhnin të njëjtën degë dhe 89% të njëjtën shkollë.

Ndërkohë të diplomuarit në degën Hoteleri-Turizëm do të përzgjidhnin të njëjtën degë në masën 97% (mesatarja e viteve 2018-2021), dhe 76% për vitin 2022, dhe të njëjtën shkollë në masë 96% (mesatarja e viteve 2018-2021), dhe 76% të diplomuarit e vitit 2022. Pra kemi një rënie me 21 pikë përqindje për përzgjedhjen e së njëjtës degë dhe 20 pikë përqindje për përzgjedhjen e së njëjtës shkollë nga të diplomuarit e degës Hoteleri-Turizëm.

Të diplomuarit në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore do e përzgjidhnin të njëjtën degë dhe shkollë në masën 100%.


Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2022)

		Ekonomi-Biznes	Hoteleri-Turizëm	Shërbime Sociale dhe Shëndetësore
Të diplomuar në 2018	Degë	83%	97%	
	Shkollë	92%	94%	
Të diplomuar në 2019	Degë	100%	100%	
	Shkollë	100%	100%	
Të diplomuar në 2020	Degë	75%	94%	
	Shkollë	75%	94%	
Të diplomuar në 2021	Degë		97%	100%
	Shkollë		97%	75%
Të diplomuar në 2022	Degë	88%	76%	100%
	Shkollë	75%	76%	100%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2018:** N_{EB}=12, N_{HT}=33; **Baza 2019:** N_{EB}=9, N_{HT}=13; **Baza 2020:** N_{EB}=8, N_{HT}=31; **Baza 2021,** N_{HT} =30, N_{SHSSH}=8; **Baza 2022:** N_{EB}=8, N_{HT}=21, N_{SHSSH}=6

Të ndara sipas gjinisë përzgjedhja e të njëjtës degë studimi jepet në figurën 30. Sikurse vihet re, për vitin 2022, 85% e vajzave dhe 82% e djemve do të përzgjidhnin të njëjtën degë studimi. Mesatarja e viteve 2018-2021 ka qenë 88% për vajzat dhe 95% për djemtë. Si rezultat, vërehet një rënie me 3 pikë përqindje përzgjedhja e të njëjtës degë për vajzat dhe me 13 pikë përqindje për djemtë.


Figura 30: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rumbullakosjes, shumat e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza M:** 2018 (N=48); 2019 (N=12); 2020 (N=28); 2021 (N=26); 2022 (N=22); **Baza F:** 2018 (N=21); 2019 (N=10); 2020 (N=11); 2021 (N=12); 2022 (N=13)

Edhe për përzgjedhjen e së njëjtës shkollë, vërehet se vajzat do e përzgjidhnin të njëjtën shkollë në masën 77% (2022) dhe djemtë në masën 82%. Mesatarja e viteve 2018-2021 ka qenë 93% për vajzat dhe po aq për djemtë (93%).

Figura 31: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rumbullakosjes, shumat e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza M:** 2018 (N=48); 2019 (N=12); 2020 (N=28); 2021 (N=26); 2022 (N=22); **Baza F:** 2018 (N=21); 2019 (N=10); 2020 (N=11); 2021 (N=12); 2022 (N=13)

3.12 Planet për të ardhmen

Të pyetur për planet që kanë të diplomuarit për të ardhmen e tyre të afërt në aspektin profesional dhe të kualifikimit të mëtjshëm (shiko tabelën 14), 40% e të diplomuarve në vitin 2022 kanë pohuar se kanë dëshirë të kenë filluar biznesin e tyre. Aspiratat për sipërmarrje në këtë vit kanë shënuar rritje me 8 pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2016-2021 e cila ka qenë 32%. Ndërkohë, ka pësuar një rënie me 5 pikë përqindje në raport me një vit më parë.

Parë në një këndvështrim krahasues, në planet e tyre për të ardhmen, mesatarisht 27% e të diplomuarve shprehen se dëshirojnë të jenë të punësuar dhe 20% të gjejnë një punë të lidhur ngushtë me fushën e tyre të studimit (mesatarja e 7 brezave). Ndërkohë, 16% (mesatarja e 7 brezave) shprehen se do ndjekin studime të mëtjshme dhe 20% se duan të emigrojnë jashtë vendit. Ndërkohë, dëshira për migrim të brendshëm është 0% për të gjashtin vit radhazi.

Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Të jem punësuar	25%	13%	58%	32%	26%	21%	14%
Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit	3%	13%	13%	23%	23%	32%	31%
Të kem filluar biznesin tim	12%	13%	9%	55%	59%	45%	40%
Të kem ndjekur studime të mëtjshme	12%	38%	16%	9%	8%	13%	17%
Të kem emigruar jashtë vendit	0%	63%	9%	23%	18%	8%	17%
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	36%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
Tjetër	36%	0%	10%	0%	3%	3%	3%

Shënim: Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishta. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=24), 2017 (N=8), 2018 (N=69); 2019 (N=22); 2020 (N=39); 2021 (N=38); 2022 (N=35)

4. Përfundime

Në këtë raport paraqiten rezultatet kryesore nga gjurmimi i të diplomuarve të shkollës Kristo Isak duke filluar me brezin e nxënësve të diplomuar në vitin 2016.

Disa nga gjetjet kryesore të gjurmimit për të diplomuarit e 2022 janë përmbledhur më poshtë:

- 100% e të diplomuarve të 2022 u gjurmuan një vit pas diplomimit.
- Nga një total prej 35 të anketuarish, 54% e tyre ishin në marrëdhënie pune (punësim/vetëpunësim), 26% pa punë, 11% po ndiqnin kualifikime të mëtjshme dhe 3% ishin të punësuar por edhe studionin në të njëjtën kohë.
- Mesatarisht, 48% e të diplomuarve në të shtatë brezat e gjurmuar janë në marrëdhënie pune një vit pas diplomimit, ndërsa 33% janë të papunë.
- 38% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes, 62% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 67% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore janë të punësuar. Ndërkohë,

50% e të diplomuarve në degën Ekonomi-Biznes, 19% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 17% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore janë të papunë.

- 70% e të diplomuarve në 2022 pohojnë se puna që ata bëjnë lidhet me studimet e tyre. Përqindja e të diplomuarve që janë shprehur se i përdorin njohuritë në vendin e punës “shumë/jashtëzakonisht shumë” për vitin 2022 është 75%. Vërehet një ulje me 8 pikë përqindje në krahasim me vitin 2021.
- Shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 5% më pak se paga minimale, 20% paga minimale-35,000 lekë, 10% në fashën 35,001-50,000 lekë, 15% në fashën 50,001-65,000 lekë, 20% në fashën 65,001-80,000 lekë dhe 30% paguhen më shumë se 80,001 lekë. Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara pasqyron një përmirësim të nivelit të pagave të të diplomuarve, sidomos në tre brezat e fundit. Kështu, përqindja e atyre që marrin një pagë më shumë se 80,001 lekë është rritur me 27 pikë përqindje në raport me vitin 2020 (30% në 2022, 13% në 2020).
- Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve vëmë re se 67% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 31% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm paguhen më shumë se 80,001 lekë. Për më tepër, 33% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 23% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm paguhen me një pagë 65,001 – 80,000 lekë. Ndërkohë, të diplomuarit në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore (100%) paguhen me pagë minimale-35,000 lekë.
- 79% e të diplomuarve janë punësuar para se të diplomohen, kjo shënon një rritje në raport me vitin 2021 ku vetëm 52% e të diplomuarve gjenin një punë para se të diplomoheshin. Ndërkohë, 4% janë punësuar një muaj pas diplomimit, 8% 3 – 6 muaj pas diplomimit dhe 8% 6 - 9 muaj pas diplomimit.
- Të diplomuarit përgjithësisht ndihen të sigurt dhe të kënaqur në punën e tyre aktuale, ku rreth 68% e tyre janë përgjigjur “të sigurt/shumë të sigurt” dhe 64% “të kënaqur ose shumë të kënaqur. Vërehet një korrelacion pozitiv mes sigurisë dhe kënaqësisë në vendin e punës.
- Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit është 26%. Në vlera absolute kjo shifër shkon në 9 (nëntë) të diplomuar të papunë. Të pyetur nëse po kërkojnë për një mundësi punësimi, 4 prej tyre (44%) u përgjigjën po.

Sipas rezultateve të të diplomuarve në vitin 2022, të gjurmuarve vlerësojnë se çdo aspekt i shkollës ka nevojë për përmirësim “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Përkatësisht, bashkëpunimi me bizneset (74%), praktika në shkollë (71%), praktika në biznes (71%), këshillimi